



Organization for Security and Co-operation in Europe
MISSION IN KOSOVO

Fjalimi i Ambasadorit Werner Wnendt
në mbledhjen e dytë të Forumit të Zgjedhjeve
09 shtator 2005

Jam i nderuar që jam këtu dhe dua t'iu dëshiroj mirëseardhje në mbledhjen e dytë të Forumit të Zgjedhjeve. Si Kryesues i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, dëshiroj të shfrytëzoj këtë rast dhe të jap një fjalim hyrës në emër të këtij Komisioni.

KQZ-ja ka vendosur të krijojë Forumin e Zgjedhjeve në bazë të Rregullores 2004/9 të UNMIK-ut mbi themelimin e KQZ-së.

Zgjedhja e një sistemi zgjedhor është një ndër vendimet institucionale më të rëndësishme për çdo demokraci. Në gati të gjitha rastet, zgjedhja e një sistemi të veçantë të zgjedhjeve ka efekt të madh në jetën e ardhshme politike të elektoratit. Forumi ka për qëllim të ndihmojë KQZ-në në themelimin e një kornizë zgjedhore të ripërtirë dhe të zbatueshme në Kosovë.

Si mund ta arrijmë këtë qëllim?

Një Forum sipas definicionit është vendi ku të gjithë qytetarët mblidhen për të diskutuar një mënyrë produktive si të mirren me çështjet e rëndësishme për shoqërinë.

Për të gjetur një zgjidhje të mirë për një sistem zgjedhor në Kosovë, është me rëndësi që ju të punoni së bashku. Ju duhet ta elaboroni një sistem zgjedhor me të cilin secili komunitet në Kosovë mund t'a identifikojë veten. Diskutimet dhe debatet konstruktive janë poashtu pjesë e punës suaj. Unë shpresoj se të gjitha partitë, komunitetet dhe organizatat civile do ta shfrytëzojnë mundësinë për të shprehur mendimet e tyre në lidhje me sistemin zgjedhor.

Marrja në konsiderim e interesave partiake është gjithmonë një faktor në zgjidhjen e kornizave zgjedhore. Sidoqoftë, përllogaritjet e interesave politike afat-shkurtëra mund të lënë nën hije pasojat afat-gjata të një sistemi të veçantë zgjedhor. Duke pasur këtë parasysh, u bëj apel anëtarëve të Forumit të Zgjedhjeve të mendojnë gjatë secilës fazë të procesit demokratik në Kosovë dhe se si mund të kontribuojnë personalisht për të forcuar strukturat demokratike të Kosovës.

Jam i sigurtë se puna e Forumit të Zgjedhjeve do të jetë një kontribut thelbësor në stabilitetin dhe demokracinë në Kosovë. OSBE-ja është e gatshme të përkrahë punën tuaj gjatë gjithë kohës.

Ju faleminderit, dhe fat të mbarë.